| ***C.2.*** | ***Shoqëria Civile, Media, Transparenca dhe Pjesëmarrja e Publikut*** | | | | |
| C.2.1. | Ngritja e nje *E-Gov-Service* – portal qendror qeveritar qe do te pasqyroje te gjitha sherbimet publike<br>▪ Informacion i perqendruar, i ofruar per publikun ne lidhje me sherbimet publike dhe bashkerendimi me i mire i informacionit ndermjet institucioneve qendrore | Zyra e Ministrit te Shtetit<br>GMAK<br>Ministrite e linjes | Maj 2004 | **Mbeshtetja financiare** | - Numri i perdoruesve<br>- Njohja e publikut me sherbimet e informacionet e paraqitura |
| C.2.2. | Krijimi i zyrave te informacionit ne te gjitha institucionet publike me interes per publikun | Institucionet publike<br>Dpt. i Informacionit ne KM | Dhjetor 2003 | Vonesa ne hapjen e zyrave te informacionit | Informimi me i sakte i publikut per te drejtat e veta dhe detyrimet e administrates publike<br>- Numri i institucioneve qe kane ngritur zyra informimi<br>- Numri i personave qe kane marre informacion nga keto zyra<br>- Perqindja e atyre qe i gjejne keto zyra te dobishme<br>- Perqindja e zvogeluar (e matur) e ankesave per mungesen e informacionit dhe transparences |
| C.2.3. | Zbatimi i ligjit nr. 8503, date 30.6.1999, "Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare"<br>▪ Pergatitja e rregulloreve ne çdo institucion per afishimin e dokumenteve zyrtare, te disponueshme per publikun | Avokati i Popullit<br>Te gjitha institucionet | Maj 2004 | Nuk ka | - Numri i çeshtjeve qe jane derguar per zgjidhje<br>- Numri i çeshtjeve te zgjidhura<br>- Numri i ankesave |
| C.2.4. | Funksionimi i Komitetit TrePalesh, ne zbatim te memorandumit te mirekuptimit dhe informimi i publikut, nepermjet deklaratave te perbashketa per shtyp | PP<br>Ministri i Shtetit | Tetor 2003 | Nuk ka | - Numri i takimeve<br>- Numri dhe lloji i deklaratave per shtyp<br>- Numri i çeshtjeve te trajtuara ne takime |

| NR. | MASAT | INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUESE | AFATI | RREZIQET | TREGUESIT E SUKSESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Shoqeria civile | Çdo tre muaj | | |
| C.2.5. | Krijimi i nje programi koherent per informimin e publikut nepermjet mas-medias ne lidhje me masat antikorrupsion | GMAK<br>Shoqeria civile<br>Sindikatat<br>Media | Maj 2004 | Vonesa ne hartimin e programit<br>Probleme financiare e teknike | - Programi i publikuar dhe i matshem ne kohe e ne cilesi<br>- Numri i publikimeve |
| C.2.6. | Publikimi i raporteve te GMAK-ut | GMAK | Ne vazhdimesi | **Mungese e burimeve financiare** | Numri i raporteve te publikuara |
| C.2.7. | Organizimi i tryezave te rrumbullaketa dhe veprimtarive rajonale | GMAK<br>Shoqeria civile<br>ZMQ<br>Sindikatat | Ne vazhdimesi | **Mungese e burimeve financiare** | - Numri i tryezave te rrumbullaketa<br>- Numri i veprimtarive rajonale<br>- Numri i pjesemarresve<br>- Numri i tematikave |
| C.2.8. | Hartimi dhe kryerja e sondazheve te ndryshme te cilat matin nivelin e e korrupsionit te perceptuar nga publiku | GMAK<br>Shoqeria civile<br>Sindikatat<br>*Donatoret* | 2003-2004 | Informacione jo shume te sakta dhe konkluzione jo shume te besueshme<br>**Mungese e burimeve financiare** | - Realizimi i sondazheve<br>- Publikimi i rezultateve<br>- Matja e performances se punes se bere ne zbatim te masave antikorrupsion |
| C.2.9. | Seanca degjimore te komunitetit te biznesit, shoqerise civile dhe sindikatave ne mbledhjet e Bordit Antikorrupsion | GMAK<br>Shoqeria civile<br>Komuniteti i biznesit<br>Sindikatat | Dhjetor 2003<br><br>Maj 2004 | Nuk ka | - Numri i seancave degjimore<br>- Numri i pjesemarresve<br>- Perfaqesimi ne media si ngjarje dhe jehona ne shtyp |
| C.2.10. | Perfshirja dhe zhvillimi i disa veprimtarive dhe oreve edukative, fakultative, per luften kunder korrupsionit ne procesin e mesimdhenies ne shkolla, si dhe ne veprimtarite e strukturave te shoqerise civile | MASH<br>FSASH<br>OJF | Maj 2004 | Ministria nuk miraton programin<br>**Kostot e procesit** | - Lloji i moduleve dhe koha e pergatitjes<br>- Matja e perceptimit te nxenesve per perfshirjen e ketyre moduleve ne tekstet mesimore |
| C.2.11. | Transparenca e rezultateve ne komunikimin e KLSH-se me institucionet e tjera dhe informimi i vazhdueshem i Kuvendit dhe publikut per te ndikuar ne procesin e bashkepunimit<br><br>Publikimi i planit te kontrollit per veprimtarite e vitit ne vazhdim | KLSH<br><br>KLSH | Ne vazhdim<br><br>Shkurt-Mars 2004 | Mosinformimi ne afat dhe ne kohen e duhur per çeshtjet shqetesuese | - Mjetet ekzistuese te perdorura, sa jane<br>- Sa do te shtohen ato ne dobi te rritjes se transparences<br>- Sa te informuar jane Kuvendi dhe qytetaret (rezultatet e anketimeve)<br><br>Hartimi dhe publikimi i planit te kontrollit |

| NR. | MASAT | INSTITUCIONET PERGJEGJESE / *BASHKEPUNUESE* | AFATI | RREZIQET | TREGUESIT E SUKSESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | Botimi i rezultateve, i raporteve dhe konkluzioneve te kontrollit, çdo tre muaj, ne nje buletin informativ dhe ne faqe interneti. | KLSH | Nje here ne tre muaj. | Mosevidentim dhe mosnjohje e rekomandimeve; si rezultat nuk kane vlere kontrollet nese nuk merren masa per zbatimin e rekomandimeve | - Rritja e transparences ne procesin e kontrollit<br>- Informimi me i mire i publikut dhe sensibilizimi i tij.<br>- Numri i raporteve te botuara |
| C.2.12. | Publikimi i raporteve 6-mujore per veprimtarine e strukturave te auditit | MF | Çdo tremujor | Mosinformim ne kohe i paleve te interesuara | - Mireinformimi dhe mbajtja ne korrent e paleve te interesuara<br>- Numri dhe cilesia e raporteve te pergatitura |
| C.2.13. | Rritja e transparences ne marredheniet me tatimpaguesit dhe publikun<br>▪ Sqarimi dhe shpjegimi i legjislacionit ne median e shkruar dhe elektronike, botimi i guidave, broshurave etj., perdorimi i linjave telefonike 24-oreshe, per denoncimin e veprimeve korruptive te punonjesve | DPT | Ne vazhdimesi | Keqinformimi i publikut<br><br>Mosnjohja e informacionit | - Permiresimi i treguesit te permbushjes vullnetare te detyrimeve nga tatimpaguesit (pagimit vullnetar te tatimeve).<br>- Pakesimi i masave shtrenguese per mbledhjen me force te detyrimeve. |
| C.2.14. | ▪ Zbatimi i programit te informacionit dhe edukimit per komunitetin e biznesit dhe nxitja e angazhimit te biznesit per te gjitha ndryshimet ligjore dhe rregullatore qe jane me interes per te<br>▪ Zhvillimi i bashkepunimit ndermjet sektorit te biznesit dhe institucioneve qeveritare, per te identifikuar problemet, prioritetet dhe per te hartuar politikat e per te ndermarre nisma te perbashketa | ME | Ne vazhdimesi | - Publiku nuk ka informacionin e mjaftueshem per punen e bere<br>- Aplikime jo te rregullta<br>- Shkeputje e biznesit nga politikat e qeverise<br>- Shkakton çrregullime ne veprimet me biznesin | - Numri i takimeve te perbashketa<br><br>- Numri i rekomandimeve konkrete te zbatuara |
| C.2.15. | Vendosja e dialogut publik:<br>▪ Institucionalizimi i forumit/forumeve te perhershme te komunitetit te biznesit dhe qeverise<br>▪ Organizimi i programeve edukative me komunitetet e biznesit vendor, permes rrjetit te dhomave te tregtise, per procedurat e prokurimit qe kane lidhje me biznesin<br>▪ Organizimi i seminareve, tryezave te perbashketa, etj per çeshtje qe lidhen me problematikat e planit te veprimeve | ME<br>*Dhoma e Tregtise dhe e Industrise* | Ne vazhdim | Shkeputje e biznesit nga politikat e qeverise | - Forumi i krijuar<br>- Numri i programeve edukative te realizuara<br>- Numri i seminareve, tryezave te perbashketa dhe numri i pjesemarresve ne keto veprimtari<br>- Numri dhe cilesia e ndryshimeve, qe kane ardhur si rezultat i organizimit te programeve edukative |
| C.2.16. | Rritja e transparences nepermjet:<br>▪ Hapjes se faqes se KLD-se ne internet<br>▪ Nje botimi prezantues per Keshillin e Larte te Drejtesise per njohjen e tij nga publiku. | KLD | <br>Dhjetor 2003<br>Tetor 2003 | | - Numri i vizitoreve<br>- Numri i kopjeve te shitura/te shperndara |

| Nr. | Masat | Institucionet Pergjegjese / Bashkepunuese | Afati | Rreziqet | Treguesit e suksesit |
|---|---|---|---|---|---|
| C.2.17. | Rritja e transparences se sherbimeve sociale<br>▪ Fushate sensibilizuese e opinionit per njohjen e legjislacionit, perfitimet dhe sherbimet qe ofron sistemi i sigurimeve shoqerore.<br>▪ Fushate sensibilizuese per regjistrimet e subjekteve, juridike e fizike, ne sigurimet shoqerore.<br>▪ Botimi dhe shperndarja e raportit vjetor te sigurimeve shoqerore dhe materialeve te tjera informative.<br>▪ Ndjekja e procedurave per perfshirjen e emigranteve shqiptare ne skemen e sigurimit vullnetar ne kuader te grupit nderministerial te punes. | MPCS | Vazhdimisht<br>Vazhdimisht<br>Vazhdimisht<br>Dhjetor 2003 | Mungojne kapacitetet institucionale per t'iu pergjigjur interesave te publikut te gjere te interesuar ne keto fusha.<br>**Realizimi eshte ne funksion te miratimit te projektit CARDS** | - Shperndarje informacioni per sherbimet sociale nepermjet fletepalosjeve, broshurave, afisheve.<br>- Krijimi i zyrave te informacionit ne institucionet publike.<br>- Berja transparente e projekteve te OJF-ve te cilat ofrojne sherbime sociale ne projektet e Bankes Boterore per nje zbatim me efikas e shtrirje gjeografike te ketyre sherbimeve.<br>- Rritja e numrit te pjesemarresve ne skemen e sigurimeve shoqerore |
| C.2.18. | ▪ Forcimi i transparences ne sherbimet e ofruara nga institucionet shendetesore e spitalore nepermjet sistemit te publikimeve, afishimeve te tarifave etj.<br>▪ Informim i publikut per sherbimet e ofruara<br>▪ Permiresimi i njohjes se qytetareve per programin e sigurimit shendetesor te financuar nga Instituti i Sigurimit Shendetesor<br>▪ Zhvillimi i nje strategjie per te siguruar shperndarjen e listave dhe çmimeve te azhurnuara te barnave kryesore te mbuluara nga Instituti i Sigurimit te Kujdesit Shendetesor<br>▪ Zhvillimi i fushatave te informimit efektiv per te drejtat dhe perfitimet e mbuluara nga sigurimi shendetesor (broshura te ISKSH, perdorim me i mire i mjeteve te mass medias)<br>▪ Rishikimi i Kartes se te Drejtave te Pacientit dhe konsultimi me partneret e duhur te qeverise dhe te shoqerise civile per azhurnimin e saj dhe nje shperndarje me te gjere | MSH<br>MSH<br>MSH<br>MSH<br>ISKSH<br>MSH | Çdo 3 muaj<br>Vazhdimisht<br>Vazhdimisht<br>2003-2004<br>Mars 2004 | **Sigurim fondesh**<br>Bashkepunimi me shoqerine civile<br>**Sigurim fondesh**<br>Bashkepunimi me shoqerine civile<br>Arritja e organizimit te tryeezave te rrumbullaketa per konsultime sa me te gjera. | - Krahasimi i raportimeve 3-mujrore te marra<br>- Mbulimi i arritur ne struktura, cilat jane, sa efiçiente jane<br>Rezultatet e sondazheve<br>Rezultatet e sondazheve<br>Rezultatet e sondazheve<br>Permiresimi i Kartes se te drejtave te pacientit |
| C.2.19. | Organizimi i fushatave sensibilizuese per rritjen e pergjegjshmerise se popullates per problemet e korrupsionit ne shendetesi. | MSH<br>OJF | Vazhdimisht | - Pjesemarrja e ulet<br>- Formalizmi i fushatave sensibilizuese | - Numri i veprimtarive<br>- Pjesemarrja e publikut ne keto fushata |
| C.2.20. | Hapja e zyrave te ankesave neper spitale apo struktura te tjera shendetesore, nepermjet venies ne dispozicion te telefonave dhe kutive postare, si dhe te personelit qe te orientoje ankesat e ndryshme | MSH | 2003-2004 | **Sigurimi i fondeve**<br>Besueshmeria e ketyre zyrave | - Numri i ankesave te marra<br>- Raporti ndermjet ankesave te marra dhe sanksioneve ndershkuese<br>- Rritja progresive e numrit te zyrave |
| C.2.21. | Bashkepunimi per forcimin e kapacitetit te shoqatave/grupeve te | MSH | Vazhdimisht | Bashkerendimi i puneve me | - Numri i tryezave te rrumbullaketa |

| NR. | MASAT | INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUESE | AFATI | RREZIQET | TREGUESIT E SUKSESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | shoqerise civile per te monitoruar dhenien e sherbimeve sociale: Shoqata e infermiereve/mamive, Urdhri i Mjekut, Shoqata e Pacienteve Shqiptare dhe grupimet e tjera te personelit mjekesor dhe pacienteve. | Shoqeria civile | | shoqerine civile | - Numri i propozimeve te bera per permiresimin e gjendjes<br>- Numri i propozimeve te reflektuara ne vendimarrje nga MSH |
| C.2.22. | Ndertimi dhe shtrirja e nismave ekzistuese per promovimin e transparences: hapja e posteve te informacionit per pagesat dhe rimbursimin e sherbimeve dhe barnave | MSH<br>*ISKSH* | Vazhdimisht | Nuk ka | Shperndarja e informacionit me te gjitha menyrat dhe mjetet e komunikimit |
| **MIRËQEVERISJA** | | | | | |
| ***1. Reforma në Administratën Publike*** | | | | | |
| 1.1. | Qartesimi i funksioneve dhe detyrave, si dhe forcimi i kapaciteteve te strukturave koordinuese ne aparatin e KM | KM<br>Dpt. i Koordinimit | Gjate 2004 | Nuk ka | Monitorim i suksesshem |
| 1.2. | Monitorimi i zbatimit te ligjit "Statusi i nepunesit civil" | DAP | Ne vazhdim | Nuk ka | Numri i rekrutimeve; numri i te larguarve nga sherbimi civil; numri i te punesuarve me kontrate |
| 1.3. | Miratimi i rregulloreve te brendshme per çdo ministri/institucion qendror | Te gjitha Ministrite dhe institucionet qendrore | Dhjetor 2003 | Nuk ka | Funksionimi dhe zbatimi i efektshem i kompetencave te ministrive dhe institucioneve qendrore |
| 1.4. | Zbatimi i ligjit "Per faljen e kamat-vonesave te kontributeve te sigurimeve shoqerore, te papaguara".<br>▪ Sanksionimi me akte, ligjore e nenligjore, i procedurave te bashkepunimit me Tatim-Taksat dhe ISHP.<br>▪ Kalimi i pergjegjesise se mbledhjes se kontributeve nga ISSH-ja tek DPT-ja. | DPT<br>ISSH<br>*MPCS*<br>*ISHP* | Dhjetor 2003 | Vonesa ne miratimin ne kohe te kuadrit nenligjor per kalimin e operacioneve te mbledhjes se kontributeve nga ISSH ne DPT. | Realizimi i hapave sipas skemes qe do te miratohet me vendim te Keshillit te Ministrave per thithjen e operacioneve te mbledhjes se kontributeve |
| ***2. Shteti i së Drejtës, Gjyqësori, Prokuroria*** | | | | | |
| 2.1. | Bashkepunimi, ndermjet institucioneve te auditimit te brendshem, Kontrollit te Larte te Shtetit dhe Prokurorise, per kallezimet penale te bera ne Prokurori. | KLSH<br>MF/Drejtoria e Pergjithshme e Auditit<br>PP | Ne vazhdim | Mangesi ne bashkerendimin e programeve te punes dhe realizimin e veprimtarive perkatese | - Rritja e numrit te kallezimeve penale te bera prej tyre ne prokurori.<br>- Rritja e cilesise dhe paraqitja sa me e plote e materialeve te kallezimit.<br>- Rritja e nivelit te bashkepunimit dhe asistences se institucioneve te kontrollit financiar gjate hetimit dhe gjykimit te |

| Nr. | Masat | Institucionet Pergjegjese / Bashkepunuese | Afati | Rreziqet | Treguesit e suksesit |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | procedimeve penale te kallezuara prej tyre |
| 2.2. | Pregatitja dhe hartimi i rregullave, strukturave, dhe metodave per vleresimin e efektivitetit te legjislacionit | MD | Gjate vitit 2003 dhe ne vazhdim | Vonesa ne bashkerendimin e angazhimeve te ndersjella me institucionet nderkombetare<br>**Sigurimi i fondeve** | Rritja e cilesise se legjislacionit te ri dhe zbatimit te tij ne praktike |
| 2.3. | Zgjerimi dhe permiresimi i bashkepunimit gjyqesor me vendet e tjera nepermjet marreveshjeve, dypaleshe dhe shumepaleshe | MD | Gjate vitit 2003 dhe ne vazhdim | Nuk ka | - Numri i instrumenteve nderkombetare te ratifikuara.<br>- Numri i marreveshjeve, dypaleshe dhe shumepaleshe, per periudha periodike 6-mujore |
| 2.4. | Aderimi, nenshkrimi dhe ratifikimi i instrumenteve te tjera te nevojshme nderkombetare ne fushen penale | MD | Gjate vitit 2003 dhe ne vazhdim | Nuk ka | Rritja e numrit te instrumenteve ligjore nderkombetare te ratifikuara |
| 2.5. | Permiresimi i kushteve te punes dhe trajnimit te stafit te administrates gjyqesore | MD<br>*ZABGJ*<br>*SHM* | Ne vazhdim | Vonesa ne realizmin e projekteve, vendore dhe te huaja | Numri i projekteve, vendore dhe te huaja, te realizuara |
| 2.6. | Permiresimi i sistemit te administrimit dhe shkembimit te informacionit ne sistemin gjyqesor | ZABGJ<br>MD | Ne vazhdim | Vonesa ne realizmin e projekteve, vendore dhe te huaja | Numri i projekteve, vendore dhe te huaja, te realizuara |
| 2.7. | Krijimi dhe permiresimi i strukturave te marredhenieve publike ne organet e sistemit gjyqesor | KLD<br>MD | Ne vazhdim | Vonesa ne realizmin e projekteve, vendore dhe te huaja | - Numri i zyrave te ngritura<br>- Numri i ankesave |
| 2.8. | ▪ Permiresimi dhe plotesimi i kuadrit ligjor per organizimin dhe funksionimin e profesioneve te lira juridike<br>▪ Miratimi, permiresimi, dhe zbatimi i efektshem i rregullave etike | MD<br>*Dhoma e Avokateve*<br>*Dhoma e Notereve* | Dhjetor 2003 | Marredheniet ndermjet organizmave te profesioneve te lira dhe MD | - Permiresimi i cilesise se sherbimeve te profesioneve te lira juridike<br>- Numri i rasteve qe njoftohen apo identifikohen si shkelje te rregullave te etikes dhe legjislacionit perkates<br>- Rritja e besimit publik dhe besueshmerise se notereve dhe avokateve |
| 2.9. | Parandalimi dhe zgjidhja me kosto me te ulet dhe ne nje kohe me te shkurter te mosmarreveshjeve ne rruge jogjyqesore, kryesisht nepermjet miratimit dhe zbatimit te ligjeve "Per ndermjetesimin ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve" dhe atij "Per arbitrazhin" | MD | Korrik 2003<br>Dhjetor 2003 | Vonesa ne miratimin e legjislacionit | - Miratimi i dispozitave te reja ligjore nga parlamenti<br>- Lehtesimi i barres se punes se gjykatave dhe institucioneve qe merren me konfliktet<br>- Krijimi dhe funksionimi i sistemeve profesioniste per zgjidhjen alternative te konflikteve gjyqesore |

| Nr. | Masat | Institucionet Pergjegjese / Bashkepunuese | Afati | Rreziqet | Treguesit e suksesit |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | - Kosto e ulet, zgjidhje e shpejte e konfliktit dhe periudhe e shkurter |
| 2.10. | Permiresimi i rregullave te organizimit dhe funksionimit te sherbimit te permbarimit dhe kushteve te punes dhe te trajtimit te permbaruesve | MD | Dhjetor 2003 | Mungese personeli<br>**Mungese e mjeteve financiare** | - Periudha kohore dhe numri i rasteve te zbatimit te plote te titujve ekzekutive ne perputhje me urdhrat/vendimet gjyqesore<br>- Rritja e numrit dhe fushave te kontrollit dhe monitorimit te veprimtarise se strukturave te permbarimit<br>- Rritja e nivelit te besueshmerise se sherbimeve te permbarimit tek institucionet, komuniteti i biznesit dhe publiku |
| 2.11. | Krijimi i nje sistemi kompjuterik te integruar (baze te dhenash) ne sektorin e analizes per administrimin e dokumentacionit | MRP | Ne vazhdim | Mungesa e mbeshtetjes me baze logjistike<br>**Sigurimi i financimit** | Nxjerrja e konkluzioneve, prirjeve e tendencave te veprimtarise korruptive e abuzive ne radhet e efektivave policore ne shkalle vendi. |
| 2.12. | Ndryshimi i vendimit Nr. 280, date 2.6.2000, te Keshillit te Ministrave, "Rregullore e personelit te Policise se Shtetit". | MRP | Prill 2004 | Nuk ka | Rritja e pergjegjesise ne menaxhimin e burimeve njerezore. |
| 2.13. | Pergatitja dhe miratimi i marreveshjes se bashkepunimit policor me Malin e Zi dhe Maqedonine. | MRP | Dhjetor 2003 | Nuk ka | Forcimi dhe goditja e krimit nderkufitar dhe parandalimi i trafiqeve, kontrabandes dhe kalimeve te paligjshme. |
| 2.14. | Pergatitja e projektligjit "Per sherbimin shendetesor ne RSH" | MSH | Dhjetor 2003 | **Sigurimi i asistences se huaj** | Permiresimi i dispozitave baze qe do te kete efekt te drejtperdrejte ne permiresimin sherbimeve ne te gjithe sistemin e shendetesise |
| 2.15. | Rishikim i ligjit "Per sigurimet shendetesore"<br>▪ Hapi I : Shtrirje e skemes, sigurime suplementare<br>▪ Hapi II : Rishikim teresor i kuadrit ligjor te sigurimeve shendetesore | MSH, ISKSH<br>Sindikatat<br>MSH, ISKSH | Tetor 2003<br>2004 | Sigurimi i asistences se huaj<br>Arritje konsensusi ne shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit<br>Sigurimi i asistences se huaj<br>Arritje e konsensusit | - Permiresimi dhe plotesimi i dispozitave qe kane te bejne me shtrirjen e skemes se sigurimeve shendetesore ne spitale ne ekzaminimet e shtrenjta dhe sigurimet shendetesore suplementare<br>- Kryerja e studimit, hartimi i paketes se dispozitave perkatese |
| 2.16. | Permiresimi i ligjit "Per ushqimin" | MSH | Tetor 2003 | Nuk ka | Kryerja e studimit, hartimi i paketes se dispozitave perkatese |

| Nr. | Masat | Institucionet Pergjegjese / Bashkepunuese | Afati | Rreziqet | Treguesit e suksesit |
|---|---|---|---|---|---|
| **3. Menaxhimi, Kontrolli i Financave dhe i Fondeve Publike** | | | | | |
| 3.1. | Rritja e pergjegjesise se kontrolloreve dhe hallkave strukturore ne KLSH, me qellim qe te zbatohet nje kontroll efektiv dhe i besueshem. | KLSH | Ne vazhdimesi | Nuk ka | Rritja e efektivitetit te kontrollit permes rritjes se pergjegjesise dhe ndergjegjesimit te personelit per detyrat ne perspektive. |
| 3.2. | Fillimi i kompjuterizimit te sistemit te thesarit per te siguruar informacion te hollesishem dhe te shpejte<br>▪ Faza e pare<br>▪ Faza e dyte | MF | Deri ne fund te *vitit 2003*<br><br>2005 | **Sigurimi i asistences financiare dhe teknike**<br>Vonese ne dhenien e informacionionit te sakte | Mbarimi i projektit pilot per Degen e Thesarit – Tirane. |
| 3.3. | Rishikimi i detyrimeve per mallrat e tranzituara dhe krahasimi me periudhat e meparshme, me qellim qe te behen permiresime ne sistemin ekzistues | DPD | Ne vazhdim | - Informacioni i perdorur per raportim nuk eshte i sakte.<br>- Mungesa e stafit te trajnuar<br>- Mungese e asistences teknike | - Ulja e ndjeshme e numrit te deklaratave te paçiftosura.<br>- Numri i raportimeve mujore nga deget per tranzitet e pambyllura qe me pas jane bere objekt kontrolli.<br>- Zbatimi i efektshem i udhezimit "Per procedurat ligjore per rikuperimin me force te borxhit doganor". |
| 3.4. | ▪ Rishikimi çdo tremujor i nivelit te gjobave dhe konfiskimeve te zbatuara me pare, ne menyre qe te percaktohen permiresimet qe duhen bere ne sistem<br>▪ Prezantimi dhe perdorimi i teknikave te reja per kontrollin pas-doganor<br>▪ Rishikimi dhe permiresimi i sistemit te informacionit per detyrimet qe rrjedhin nga deklarimet doganore dhe forcimi i masave per arketimin e tyre. | DPD | Ne vazhdimesi | Ulje e arketimit te te ardhurave dhe rritje e evazionit | Rritja e arketimit te te ardhurave doganore dhe parandalimi i evazionit<br><br>Rritja e arketimit te borxhit doganor |
| 3.5. | Permiresimi i punes dhe cilesise ne pikat doganore dhe percaktimi i afateve standarde per zhdoganimet | DPD | Ne vazhdim | Renie e cilesise se punes | Permiresim i ndjeshem i cilesise se kontrolleve *dhe ulja e kohes se perpunimit* |
| 3.6. | Permiresimi i strukturave te kontrollit te brendshem, te procedurave te tyre te kontrollit, miratimi i nje plani vjetor kontrolli | DPD | Ne vazhdim | Abuzime me fondet | Permiresim i ndjeshem i procedurave te kryerjes se kontrolleve |
| 3.7. | Rritja e te ardhurave veçanerisht nga TVSH-ja :<br>▪ Perpunimi dhe shkembimi i informacionit te grumbulluar ndermjet degeve, dhe ndermjet bleresve dhe furnitoreve taksapagues<br>▪ Rritja e aftesive per kontrollin dhe verifikimin e transaksioneve te [illegible] | DPT | Ne vazhdim | Moszbatimi i skemes per perpunimin dhe perdorimin e informacionit te grumbulluar | Perqindje qe tregojne rritjen e te ardhurave nga TVSH-ja |

| NR. | MASAT | INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUESE | AFATI | RREZIQET | TREGUESIT E SUKSESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | taksapaguesve | | | | |
| 3.8. | ▪ Bashkepunimi me organet e pushtetit vendor per rritjen e nivelit te kontrollit ne perdorimin e fondeve te ndihmes ekonomike.<br>▪ Rritja e nivelit te kontrollit ne perdorimin e fondeve te ndihmes ekonomike | MPCS<br>*MPVD* | Ne vazhdim | - Abuzimi me fondet<br>- Mungesa e angazhimit te institucioneve per zbatimin e detyrave te veçanta nga secili ne praktike per te cilat eshte rene dakord ne kuadrin e bashkepunimit institucional | Parandalimi i efekteve abuzive ne perdorimin e fondeve publike.<br><br>Numri i rasteve te konstatuara. |
| 3.9. | Rritja e nivelit te bashkepunimit dhe bashkerendimit te veprimtarise institucionale per kontrollin e tregut te punes dhe minimizimin e punes se zeze. | MPCS<br>*ISHP*<br>*SHKP*<br>*ISSH*<br>*DPT* | Ne vazhdimesi | Mungesa e vullnetit te paleve per te bashkepunuar | - Ulja e numrit te perfituesve dhe rritja e mases se perfitimit per familje.<br>- Rritja e nivelit te kontribuesve, si dhe rritja e te ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqerore.<br>- Rritja e nivelit te bashkepunimit nderinstitucional, duke u sanksionuar ne akte, ligjore dhe nenligjore |
| 3.10. | Institucionet te bejne prokurim te perqendruar te ndertimeve dhe te mallrave apo sherbimeve me konsum te madh | Te gjitha institucionet | Ne vazhdimesi | Mungesa e transmetimit te informacionit | Perdorimi sa me me efektivitet i fondeve publike |
| ***4. Operacionet e Biznesit dhe Procesi i Privatizimit - Transparenca dhe Integriteti i Tyre*** | | | | | |
| 4.1. | Ndertimi i programeve te bashkerendimit, ndermjet institucioneve qe marrin pjese ne kuader te privatizimit. | ME | Janar 2004 | Mossukses ne privatizim | - Rregulla te qarta bashkerendimi ndermjet institucioneve<br>- Bashkerendim i efektshem |
| ***5. Shoqëria Civile, Media, Transparenca dhe Pjesëmarrja e Publikut*** | | | | | |
| 5.1. | Shperndarja e informacionit (permes broshurave, fletepalosjeve, afisheve, etj.) per dhenien e sherbimeve publike, broshura te cilat shpjegojne sherbimet qe ministrite i ofrojne publikut | Te gjitha institucionet publike | Ne vazhdimesi | Nivel i ulet i angazhimit te ministrive | - Procedura te qarta per sherbimet publike<br>- Numri i personave qe i marrin keto informacione<br>- Perqindja e atyre qe jane te kenaqur me informacionin qe marrin |

**VENDIM**
**Nr.675, datë 25.9.2003**

## PËR PËRCAKTIMIN E POCEDURAVE TË KRIJIMIT, ORGANIZIMIT DHE MBYLLJES SË INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a" të nenit 23 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimi, riorganizimi dhe mbyllja e institucioneve të formimit profesional në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, të bëhet me urdhër të Ministrit.
2. Institucionet e formimit profesional krijohen:
- mbi bazën e kërkesës së tregut të punës;
- kur ndryshojnë kushtet dhe kualifikimi për kategori të caktuara punësh;
- kur investimet e reja apo zbatimi i teknologjive bashkëkohore duhet të realizohet nga punonjës të kualifikuar;
- në raste të tjera, në varësi të politikave të punësimit.
3. Institucionet e formimit profesional riorganizohen:
- për shkak të përmbushjes së disa qëllimeve dhe shtimit të disa qëllimeve të tjera formuese;
- kur lind nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë me institucionin e arsimit profesional për rritjen e frytshmërisë së përdorimit të infrastrukturës së arsimit dhe formimit profesional;
- mbi bazën e studimeve, nga të cilat rezulton se riorganizimi sjell përdorim racional të personelit, shfrytëzim efektiv të mjediseve dhe përvetësim maksimal gjatë procesit të formimit profesional;
- për shkak të domosdoshmërisë së një bashkëpunimi të ri me subjekte të tjera shtetërore ose private, në dobi të një formimi aktiv, nëpërmjet praktikave në ndërmarrje, institucione apo në qendra të ndryshme pune;
- me kërkesë të organeve të njësive të qeverisjes vendore, mbi bazën e studimeve të argumentuara;
- mbi bazën e kërkesës së banorëve të zonës, ku ushtrojnë veprimtarinë, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe me struktura të reformuara;
- në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave të punësimit.
4. Me urdhrin e krijimit ose të riorganizimit të këtyre institucioneve miratohet dhe statuti i tyre, i cili duhet të jetë në përputhje me statutin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Institucionet e formimit profesional mbyllen kur:
- kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë krijuar ose kur nuk përmbushin asnjë qëllim;
- dendësia e institucioneve të formimit profesional në rajon është e madhe dhe funksionimi i institucionit të formimit profesional publik është i panevojshëm;
- frekuentimi i kurseve është i papërfillshëm;
- shpenzimet buxhetore për mbajtjen e institucionit janë të pajustifikueshme;
- banorët e zonës ku ushtron veprimtarinë institucioni nuk shprehin asnjë interes për të përfituar nga shërbimet që ofrohen aty;
- nga politikat përkatëse të formimit profesional rezulton se institucioni duhet transferuar në një zonë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë.
6. Në urdhrin ku përcaktohet mbyllja e një institucioni të formimit profesional parashikohen edhe trajtimi i punonjësve të institucionit që dalin të papunë dhe destinacioni i mjeteve, monetare e materiale, në përfundim të likuidimit përkatës.
7. Qendrat e formimit profesional, të cilat funksionojnë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të riorganizohen dhe funksionojnë mbi bazën e statuteve të miratuara në përputhje me statutin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Vendimi nr.306, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e sistemit të formimit profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

## STATUT-TIP
## I INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të...........

### KREU I
### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1
#### Objekti

Institucionet e formimit profesional kanë për qëllim të ofrojnë formim dhe kualifikim profesional të personave, në mbështetje të politikave të përgjithshme shtetërore dhe në dobi të punësimit të zgjedhur lirisht, si dhe këshillim e orientim profesional.

#### Neni 2
#### Pozita juridike

1. Institucionet e formimit profesional janë persona juridikë publikë, në varësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse.
2. Institucionet e formimit profesional gëzojnë privilegjet dhe lehtësirat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

#### Neni 3
#### Emërtimi dhe selia

Krijohet .........., si institucion i formimit profesional, në varësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Ky institucion vepron brenda territorit të............. dhe ka selinë në.............

#### Neni 4
#### Kapitali fillestar dhe mjetet materiale

Kapitali fillestar i institucionit është.............. Institucionit i jepen në përdorim mjediset...........

#### Neni 5
#### Marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në fushën e punësimit mbështesin dhe nxisin veprimtarinë e krijimit të kapaciteteve për formim profesional nëpërmjet zhvillimit dhe zgjerimit të sistemit të formimit profesional publik.
2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, nëpërmjet institucioneve të formimit profesional, zbaton politikën shtetërore të formimit profesional.
3. Institucionet e formimit profesional bashkëpunojnë me institucionet e arsimit profesional, zyrat e punësimit, me organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, me universitetet, me INSTAT-in etj., për problemet e formimit profesional në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për hartimin e

kurrikulave, standardeve të profesioneve, trajtimin e personelit, realizimin e këshillimit dhe orientimit profesional.

## KREU II
## VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL

### Neni 6
### **Kursantët**

1. Kursantë janë personat që kanë mbaruar arsimin shkollor të detyrueshëm dhe që dëshirojnë të formohen profesionalisht.

2. Kanë përparësi në pranimin si kursantë ata persona që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura, personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në procesin e reformimit, ristrukturimit dhe privatizimit, vajzat dhe nënat e papuna, nënat me shumë fëmijë, vajzat dhe gratë e trafikuara, gratë e divorcuara e me probleme sociale, personat me aftësi të kufizuara, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, personat që kthehen nga emigracioni e me probleme ekonomike, të sapodiplomuarit, si dhe personat që kanë vuajtur dënimin me burg.

### Neni 7
### **Procedura e regjistrimit, vlerësimit dhe certifikimit**

Procedurat e regjistrimit, vlerësimit përfundimtar dhe mënyra e certifikimit të kursantëve në institucionet e formimit profesional përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

### Neni 8
### **Hapja e kurseve të reja**

Institucionet e formimit profesional hapin kurse:

- në përputhje me kërkesën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në zbatim të politikave shtetërore;
- në përputhje me nevojat imediate të tregut të punës.

### Neni 9
### **Tarifat e kurseve të formimit profesional**

Institucionet e formimit profesional ofrojnë kurse me tarifa të favorizuara ose pa pagesë, në zbatim të politikave shtetërore të nxitjes së punësimit, sipas përcaktimit të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, për punëkërkues të papunë dhe për shtresa të popullsisë në nevojë, që trajtohen nga zyrat e punësimit dhe kurse kundrejt pagesës, për personat e tjerë që kërkojnë të marrin pjesë në to.

### Neni 10
### **Veprimtaritë e shërbimit dhe të prodhimit**

1. Institucionet e formimit profesional kanë të drejtë të zhvillojnë çdo lloj veprimtarie në funksion të formimit profesional të kursantëve. Ato mund të kryejnë edhe shërbime ose veprimtari prodhuese me përfitime financiare, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimin e institucionit për realizimin e programeve të formimit profesional dhe të mos përbëjë qëllim në vetvete.

2. Këto institucione bashkë me qendrat e përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, duke kontraktuar me persona fizikë ose juridikë.

3. Të ardhurat e krijuara nga këto veprimtari përdoren për mbulimin e nevojave të këtyre

institucioneve dhe zgjerimin e veprimtarisë së tyre.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 11
**Organet drejtuese**

Organet drejtuese të institucioneve të formimit profesional janë:
- këshilli drejtues;
- drejtori.

Neni 12
**Përbërja e këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues është organ kolegjial që realizon drejtimin e veprimtarisë së institucionit të formimit profesional. Në institucionet e mëdha ky këshill ka në përbërje jo më shumë se 6 anëtarë, ndërsa në institucionet e vogla jo më shumë se 4 anëtarë.
2. Anëtarët e këshillit drejtues të institucionit të formimit profesional emërohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe propozohen nga institucionet: një përfaqësues nga zyra e punës, një përfaqësues nga bashkia, një përfaqësues nga dhoma e tregtisë dhe e industrisë, një përfaqësues nga punëdhënësit dhe një nga punëmarrësit. Drejtori i institucionit të formimit profesional është anëtar i këshillit drejtues.
3. Anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen me 20% të pagës së drejtorit të institucionit.

Neni 13
**Mbledhjet e këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues thirret me kërkesë të drejtorit ose të shumicës së anëtarëve. Këshilli mblidhet sa herë e kërkon interesi i institucionit, por jo më pak se një herë në muaj.
2. Këshilli merr vendim me shumicë votash, në praninë e shumicës së anëtarëve. Në rast barazie votash, përcaktuese është vota e drejtorit.
3. Procedurat e thirrjes, të mbledhjes dhe të votimit të këshillit përcaktohen në rregulloren e këshillit, e cila miratohet nga vetë këshilli.

Neni 14
**Kompetencat e këshillit drejtues**

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:
- miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit;
- miraton strukturën organizative dhe përcakton numrin e punonjësve për veprimtarinë e përhershme;
- përcakton tarifat për kurse dhe kapacitetin maksimal të tyre, nisur nga kërkesat e tregut, si dhe mbi bazën e grupeve të veçanta të kursantëve;
- përcakton tarifat e shërbimeve dhe çmimet e mallrave që ofron;
- miraton programin ekonomiko-financiar;
- miraton llogaritë vjetore dhe raportin vjetor të veprimtarisë ekonomike të institucionit;
- përcakton pagat sipas funksioneve, indeksimin, rritjen e tyre, si dhe shpërblimet;
- përcaktimin e kritereve të marrjes në punë, të punonjësve të përhershëm dhe të instruktorëve;
- përcaktimin e pagave për instruktorët e brendshëm dhe të honorareve për instruktorët e

jashtëm;

- shqyrtimin dhe miratimin paraprak të kontratave që lidhen me të tretët.

Neni 15

**Pozita juridike e drejtorit**

1. Drejtori përzgjidhet me konkurs publik, i cili organizohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale lidh kontratë pune me fituesin e konkursit për pozicionin e drejtorit të institucionit. Afati i kontratës është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje vetëm një herë.

2. Drejtori është përfaqësues ligjor i institucionit me të tretët dhe nënshkruan në emër dhe për llogari të institucionit.

3. Paga e drejtorit përcaktohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me referencë strukturën dhe nivelin e pagave në institucionet buxhetore për pozicione dhe institucione analoge, si dhe mbi bazën e arritjeve në detyrë. Paga e drejtorit ndryshon (rritet) sa herë ndryshojnë (rriten) pagat në shkallë vendi.

Neni 16

**Kompetencat e drejtorit**

Drejtori ka këto kompetenca:

- administron veprimtarinë e institucionit;
- harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së institucionit dhe ia paraqet për miratim këshillit drejtues;
- harton planin vjetor të veprimtarisë formuese të institucionit;
- i paraqet këshillit drejtues buxhetin dhe programin për realizimin e çdo veprimtarie para fillimit të saj, në funksion të përmbushjes së programit të punës;
- harton dhe i paraqet për miratim këshillit drejtues bilancin e institucionit;
- përgjigjet për shpenzimet e bëra me buxhetin e institucionit, në përputhje me objektivat dhe qëllimin e funksionimit të institucionit;
- harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, duke përdorur konkurrimin publik, për çdo vend pune;
- bashkërendon punën me këshillin drejtues për të zbatuar me sukses politikat shtetërore dhe strategjinë e formimit profesional;
- bashkëpunon me donatorë vendas dhe të huaj për të siguruar fonde për institucionin;
- krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe të institucioneve të tjera që lidhen me këtë fushë;
- koordinon veprimet për mbështetjen e kurseve të formimit, si dhe të shërbimeve të tjera e të prodhimit në dobi të kurseve;
- mbështet veprimtaritë që lidhen me trajnimin e personelit, hartimin e kurrikulave rë reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, si dhe këshillimin e orientimin e kursantëve;
- analizon dhe vlerëson studimet e bëra për tregun e punës dhe hapjen e kurseve të reja në rajonin ku vepron institucioni i tij dhe merr masa për zbatimin e studimeve të vlefshme.

KREU IV

TË ARDHURAT DHE VEPRIMTARIA EKONOMIKE E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 17

**Burimet e financimit**

Burimet e financimit të institucioneve të formimit profesional përbëhen nga:

- fondet nga Buxheti i Shtetit ose nga qeverisja vendore për formimin profesional;
- fondet nga programet kombëtare ose ndërkombëtare;

- të ardhurat që krijohen nga vetë institucioni;
- fondet, grantet ose dhurimet e ndryshme nga subjekte publike, private, vendase ose të huaja;
- kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, sponsorizimet e ndryshme;
- si dhe fonde nga burime të tjera të lejuara nga ligji.

Neni 18
**Transferimi i fondeve buxhetore**

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit, të parashikuara në buxhetin vjetor të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për formimin profesional publik transferohen në fillim të çdo 4-mujori në llogarinë rrjedhëse të institucioneve të formimit profesional publik dhe bashkë me të ardhurat nga veprimtaritë e tjera të tyre ose me dhurimet e kontributet e tjera përbëjnë llogarinë aktive të këtyre institucioneve.

2. Institucionet e formimit profesional publik marrin fonde nga Buxheti i Shtetit në raport me kapacitetet për trajnim të kurseve të profesioneve. Zyrat përkatëse të punësimit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit saktësojnë dhe vlerësojnë çdo vit, për vitin pasardhës, kontigjentet e kursantëve, punëkërkues të papunë, të parashikuara për formimin profesional. Llogaritja e financimit bëhet mbi bazën e kostove të plota të formimit profesional për çdo kursant. Kjo bazë llogaritjeje përbën dhe financimin shtetëror të institucionit në rajonin respektiv. Zyrat përkatëse të punësimit detyrohen të plotësojnë me kursantë kapacitetet e kurseve të profesioneve.

Neni 19
**Programi ekonomik e financiar**

1. Institucionet e formimit profesional publik përcaktojnë programin ekonomik e financiar dhe marrin vendime për zbatimin e tij. Në këtë program përfshijnë në mënyrë të posaçme fondet shtetërore dhe përgjigjen për realizimin e tyre kundrejt Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

2. Institucionet e formimit profesional publik sigurojnë ekuilibrin e tyre financiar nëpërmjet fondeve që akordohen nga Buxheti i Shtetit për formimin profesional, nga të ardhurat që krijojnë vetë nga shitja e shërbimeve dhe mallrave, nga dhurimet e subjekteve vendase ose të huaja, si dhe nga kontributet.

3. Institucionet e formimit profesional publik kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo veprimtari të formimit profesional si: sipërmarrja, tenderime, prokurime të granteve të organizuara nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministira e Arsimit dhe e Shkencës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si dhe nga subjekte të ndryshme shtetërore ose private, vendase apo të huaja. Këto institucione mund të kontraktojnë, shesin apo blejnë shërbime të formimit profesional dhe shërbime e mallra, që realizohen gjatë procesit të formimit profesional të kursantëve ose që kërkohen nga ky proces. Çdo institucion mund të transferojë shërbimet e tij, kabinetet, pajisjet dhe mjetet e nevojshme didaktike në institucione të tjera e duke koordinuar këtë veprimtari me Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Neni 20
**Raportimi i treguesve dhe të dhënave**

Institucionet e formimit profesional publik mbajnë kontabilitet, përgatisin e paraqesin llogaritë vjetore dhe raportojnë periodikisht treguesit dhe të dhënat statistikore, sipas dispozitave ligjore.

Neni 21
**Kontrolli i veprimtarisë së institucioneve dhe verifikimi i llogarive**

Veprimtaria e institucioneve të formimit profesional publik dhe llogaritë vjetore të tyre kontrollohen dhe nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ky kontroll është i pavarur nga kontrollet e parashikuara në dispozitat e tjera ligjore dhe nuk i zëvendëson ato.

Neni 22
**Raporti vjetor i veprimtarisë**

1. Drejtori i institucionit të formimit publik i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, periodikisht çdo vit, raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit pas shqyrtimit e miratimit të tij në këshillin drejtues.

2. Raporti vjetor i veprimtarisë ekonomike e financiare u bëhet i njohur punonjësve.

Neni 23
**Përdorimi i të ardhurave**

Të ardhurat e institucionit të formimit profesional publik, pas realizimit të veprimtarisë vjetore, përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24
**Çështje të veçanta**

Çështje të veçanta, të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga ky statut-tip, përcaktohen në varësi të pozitës së institucionit, në statutin e posaçëm dhe në rregulloren e veprimtarisë së tij.

Neni 25
**Veprimi në kohë**

Ky statut shtrin veprimin e tij mbi çdo institucion të formimit profesional publik, në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, që është krijuar para hyrjes së tij në fuqi.

## VENDIM
## Nr.679, datë 16.10.2003

## PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË KANALIZIMEVE NË ZONAT RURALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë së furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat rurale, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

## VENDIM
## Nr.696, datë 16.10.2003

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.321, DATË 15.5.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.321, datë 15.5.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në listën e barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor bëhen ndryshimet dhe shtesat, sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Masa e mbulimit të çmimit të barnave të listës së barnave të rimbursueshme, për kategorinë e pensionistëve, është 100 për qind.".

3. Efektet financiare për vitin 2003 të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për ISKSH-në.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

LISTA E BARNAVE ME NDRYSHIME TË ÇMIMEVE REFERENCË NË LISTËN E RIMBURSIMIT 2003

| Kod Bari | Kodi ATC | Emri i barit | Njësia | Emri tregtar | Firma farmaceutike | Çmimi reference | Çmim pacienti | Çmim rimbursimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| 204/36 | L01BA01 | Methotrexatum 2,5 mg | tabl. | Methotrexat | EBEWE PHARMACEUTICALS | 11 | 0 | 11 |
| 204/110 | | | tabl. | Methotrexat | REMEDISA | 18,3 | 7,3 | 11 |
| 210/36 | L02BB01 | Tamoxifenum 10 mg | tabl. | Tamoxifen "Ebewe" | EBEWE PHARMACEUTICALS | 19 | 3,6 | 15,4 |
| 276/69 | N05AX08 | Risperidonum 2 mg | tabl. | Rispolept | JANSSEN PHARMACEUTICA | 255 | 51 | 204 |
| 43/92 | B01AA07 | Acenocoumarolum 4 mg | tabl. | Sintrom | NOVARTIS | 17 | 2,5 | 14,5 |
| 88/92 | C09CA03 | Valsartanum 80 mg | caps. | Diovan | NOVARTIS | 120 | 60 | 60 |
| 122/89 | H01AA02 | Tetracosactidum Acetatum 1 mg-1ml | amp. | Cortrosyn Depot | N.V.ORGANON | 370 | 18 | 352 |
| 122/92 | | | amp. | Synacthen Depot | NOVARTIS | 375 | 23 | 352 |
| 212/92 | L02BG04 | Letrozolum 2,5 mg | tabl. | Femara | NOVARTIS | 863 | 0 | 863 |
| 214/92 | L04AA01 | Ciclosporinum 25 mg | caps. | Sandimum Neoral | NOVARTIS | 189 | 0 | 189 |
| 215/92 | L04AA01 | Ciclosporinum 100 mg | caps. | Sandimum Neoral | NOVARTIS | 751 | 0 | 751 |
| 250/92 | N03AF01 | Carbamazepinum 2%-100 ml | fl. | Tegretol | NOVARTIS | 621 | 93 | 528 |
| 273/92 | N05AH02 | Clozapinum 100 mg | tabl. | Leponex | NOVARTIS | 77,7 | 15,5 | 62,2 |
| 298/92 | R03AC13 | Formoterolum fumarate 12 mcg (për inhalacion) | caps. | Foradil | NOVARTIS | 73 | 36,5 | 36,5 |

PASQYRA 1

LISTA E BARNAVE QË FUTEN NË LISTËN E RIMBURSIMIT TË BARNAVE 2003

| Kod Bari | Kodi ATC | Emri i barit | Njësia | Emri tregtar | Firma farmaceutike | Çmimi reference | Çmim pacienti | Çmim rimbursimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| 54/41 | B03XA01 | Erythropoietinum (Epoetin beta) 1000 Nj.N | amp. | Neorecormon | F.HOFFMANN-LA ROCHE | 2390 | 120 | 2270 |
| 55/41 | B03XA01 | Erythropoietinum (Epoetin beta) 2000 Nj.N | amp | Neorecormon | F.HOFFMANN-LA ROCHE | 4779 | 239 | 4540 |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr.698, datë 16.10. 2003**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**MARRËVESHJA**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË GREQISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Qeveria e Republikës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Greqisë, këtej e tutje të quajtura "Palë Kontraktuese", të udhëhequra nga dëshira për të nxitur marrëdhëniet dypalëshe në fushën e mjekësisë dhe duke qenë të bindur se bashkëpunimi i tanishëm do të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullsisë së dy vendeve, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e shëndetit dhe do të nxisin shkëmbimet e ndërsjella të eksperiencës së tyre, kryesisht nëpërmjet:

a) zhvillimit të programeve kërkimore të përbashkëta dhe bashkëpunimit midis qendrave kërkimore dhe shoqatave shkencore në çështje të interesit të përbashkët;

b) pjesëmarrjes së specialistëve në konferenca e seminare mjekësore të organizuara në të dy vendet;

c) shkëmbimit të informacioneve mbi çështjet që lidhen me shëndetin publik, shëndetin mjedisor, ushqimin dhe materialet higjienike;

d) bashkëpunimit ndërkufitar dhe informacionit reciprok, lidhur me shfaqjen e sëmundjeve infektive dhe sëmundjeve të tjera epidemike me shpërndarje të gjerë në territorin e tyre, me qëllim që të dyja Palët të marrin masat e nevojshme për të kufizuar përhapjen e tyre nëpërmjet tokës, detit ajrit, pasagjerëve dhe mallrave nga secila anë.

Neni 2

Palët Kontraktuese, reciprokisht, do të lehtësojnë vizita të shkurtra të shkencëtarëve, kërkuesve dhe specialistëve të tjerë në fushën e shëndetit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës.

Palët Kontraktuse bien dakord që pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit.

Shpenzimet në lidhje me akomodimin do të mbulohen nga pala pritëse.

Neni 3

Secila prej Palëve Kontraktuese, për rastet urgjente që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme,

do të japë ndihmë mjekësore falas qytetarëve të pasiguruar të Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm e të ligjshëm.

Neni 4

Palët Kontraktuese bien dakord që një numër jo më i madh se 300 shqiptarë mund të kurohen falas çdo vit në spitalet greke, që çdo herë do të përcaktohet nga një vendim i Ministrit të Shëndetësisë së Republikës të Greqisë, me kusht që:

a) ata të posedojnë një raport mjekësor të lëshuar nga një shërbim mjekësor zyrtar në Shqipëri, ku të theksohet se vuajnë nga sëmundje shumë të rënda që nuk mund të trajtohen në spitalet shqiptare, për arsye të mungesës së specialitetit mjekësor, të pajisjeve të nevojshme teknologjike ose për arsye të tjera serioze;

b) ata do të pranohen gradualisht nga spitalet greke;

c) spitalet greke mund të refuzojnë kurimin mjekësor të lartpërmendur, nëse nuk e lejojnë rrethanat;

d) shpenzimet e udhëtimit të mbulohen nga Pala Shqiptare.

Neni 5

Pala greke:

a) Do të akordojë një numër të arsyeshëm bursash për mjekët shqiptarë, me qëllim që të marrin specializimin mjekësor në spitalet greke, sipas legjislacionit grek.

b) Do të kontribuojë, brenda mundësive, nxitjen e programeve arsimore për stafin shqiptar të infermierëve dhe të nëpunësve të administratës shëndetësore dhe ekonomike, nëpërmjet organizatave shëndetësore kompetente.

Neni 6

Pala greke do të përkrahë, brenda mundësive, Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës të Shqipërisë, nëpërmjet programeve për zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor,kujdesit shëndetësor spitalor dhe organizimit të shërbimeve mjeksore në përgjithësi.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë bashkëpunimin në fushën farmaceutike në iniciativën e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave të Shqipërisë dhe Organizatës Kombëtare të Barnave të Greqisë.

Neni 8

Palët Kontraktuese do të nxisin krijimin e binjakëzimit midis spitaleve. Bisedimet përkatëse do të zhvillohen me iniciativën e spitaleve të interesuara.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën kur të dyja Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për plotësimin e formaliteteve ligjore që kërkohen nga secili vend për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kur kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, çdo marrëveshje tjetër ekzistuese midis dy Palëve konsiderohet e pavlefshme.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për 2 vjet dhe më pas do të rinovohet automatikisht për 2 (dy) vjet të tjera, po qe se nuk do të denoncohet me shkrim nga njëra prej Palëve Kontraktuese, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara përfundimit të secilës periudhë.

Në rast denoncimi të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me pikat e këtij neni, çdo program shkëmbimi ose bashkëpunimi i ndërmarrë në të dhe që nuk është plotësuar akoma do të qëndrojë i

vlefshëm derisa të përfundojë.

Firmosur në Tiranë, më 3 shtator 2003, në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, greqisht dhe anglisht, ku të dyja tekstet janë identike. Në rast divergjencash interpretimi do të mbizotërojë përkthimi në anglisht.

## V E N D I M
## Nr.28, datë 13.10.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fehmi Abdiu | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci | Anëtar i " " |
| Gjergj Sauli | Anëtar i " " |
| Alfred Karamuço | Anëtar i " " |
| Kujtim Puto | Anëtar i " " |
| Petrit Plloçi | Anëtar i " " |
| Sokol Sadushi | Anëtar i " " |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i " " |
| Kristofor Peçi | Anëtar i " " |

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 22.7.2003 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.20 Akti që i përket:

KËRKUES: MYSLYM GJOLEKA, përfaqësuar nga avokati Elton Lula, me prokurë.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE VLORË, në mungesë.
2. DEPARTAMENTI I SHËNDETIT PUBLIK VLORË, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.342, datë 13.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.262, datë 8.5.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.374, datë 6.2.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Neni 131/f i Kushtetutës, si dhe nenet 27 e 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Për shfuqizimin si antikushtetuese të këtyre vendimeve, kërkuesi parashtron këto shkaqe:

- Në gjykimin në shkallë të parë u vërtetua me aktekspertimin se vlera e investimeve të shtetit në banesë nuk i kalonte 48 %, por gjykata, pa marrë provë tjetër, shprehet në vendim se eksperti ka gabuar duke vlerësuar edhe truallin.
- Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit pa bërë analizë të plotë të provave.
- Këto shkelje i janë ngritur në rekurs Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili, pa të drejtë, vendosi mospranimin e rekursit në Dhomën e Këshillimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.256, datë 9.3.1995 Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë i ka njohur kërkuesit bashkëpronësinë me Departamentin e Shëndetit Publik të Rrethit Vlorë të një

ndërtese trikatëshe të ndodhur në fshatin Kuç. Kjo ndërtesë është kthyer në bashkëpronësi, pasi, në bazë të aktit të ekspertimit të kryer nga eksperti i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vlera e shpenzimeve që ka kryer shteti në të i kalon 50 % të vlerës së banesës, kërkesë kjo e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Mbi padinë e kërkuesit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.342, datë 13.3.2001, ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se në vlerën e përgjithshme të banesës nuk duhet të llogaritet vlera e truallit.

Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit me të njëjtin arsyetim. Ajo shprehet në vendim se ligjvënësi nuk ka lënë vend për të bërë interpretim ndryshe nga ai që ka bërë gjykata e faktit. Fjala "etj.", që ankuesi kërkon ta identifikojë me "truallin" në nenin 13/1 të ligjit, nuk mund të pranohet. Në këtë rast, vazhdon arsyetimi i gjykatës, bëhet fjalë vetëm për shpenzime të ndryshme, për ndryshime në strukturë, shtesa anësore apo shtesa kati etj., por kjo "etj.", kurrësesi nuk mund të jetë trualli në vijim të kuptimit të "ndryshimeve strukturore".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesi Myslym Gjoleka.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi ndërsa në fillim pretendoi për proces të parregullt të zhvilluar nga të gjitha gjykatat, e kufizoi kërkesën për shfuqizimin vetëm të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili sipas tij ishte i detyruar ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore, sepse në rekurs ngriheshin probleme ligjore.

Gjykata Kushtetuese, duke i shqyrtuar në tërësi pretendimet e kërkuesit për proces të parregullt në lidhje me kërkesat e neneve 42 e 131/f të Kushtetutës, çmon se shkaqet e ngritura nuk përmbajnë elemente të procesit të parregull në kuptimin kushtetues. Në këtë përfundim ajo arrin bazuar në kërkesat e nenit 131/f të Kushtetutës dhe të praktikës tashmë të konsoliduar të saj.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është kompetente për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, e drejta për një proces të rregullt ligjor është një nga të drejtat kushtetuese të individit që lidhet me rregullsinë e procesit edhe në sistemin gjyqësor. Në shqyrtimin e çështjeve të tilla, Gjykata Kushtetuese kontrollon nëse janë respektuar nga gjykatat e sistemit gjyqësor parimet themelore të procesit. Në shqyrtimin e kërkesave të tilla, Gjykata Kushtetuese kontrollon zbatimin e kërkesave të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nga ana e gjykatave të të gjitha instancave dhe nuk mund ta shtrijë këtë kontroll edhe mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shqyrtimi dhe zgjidhja e drejtë e çështjeve konkrete sipas rrethanave që paraqiten dhe analiza e provave në funksion të marrjes së një vendimi janë probleme që i takojnë juridiksionit të gjykatave të sistemit gjyqësor, sepse dhënia e drejtësisë është atribut vetëm i këtyre gjykatave. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në gjithë praktikën e saj për shqyrtimin e kërkesave të tilla të individëve për mbrojtje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Bazuar në këto argumente, për kërkesën objekt shqyrtimi të paraqitur nga kërkuesi Myslym Gjoleka, Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjë vlerësim tjetër të çështjes mbi atë që kanë bërë gjykatat e të gjitha shkallëve të gjykimit. Ajo nuk mund të marrë në shqyrtim faktin nëse në këtë rast duhet të llogaritet në vlerën e ndërtesës edhe vlera e truallit. Një disponim i tillë është jashtë kompetencës së saj, sepse do të njësohej me zgjidhjen në themel të çështjes.

Lidhur me gjykimin e çështjes, është e rëndësishme të theksohet se si gjykata e faktit, ashtu edhe ajo e apelit, nuk i kanë injoruar pretendimet e kërkuesit, por u kanë dhënë përgjigje atyre me vendim të arsyetuar. Në këto kushte, përderisa palëve u është dhënë mundësia për të parashtruar dhe mbrojtur pretendimet e tyre dhe vendimi është marrë brenda kompetencave, bazuar në administrimin dhe çmuarjen e provave të marra gjatë gjykimit, sipas parimit të kontradiktoritetit, procesi ligjor nuk mund të konsiderohet si i parregullt.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**V E N D I M**
**Nr.29, datë 13.10.2003**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fehmi Abdiu | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci | Anëtar i " " |
| Alfred Karamuço | Anëtar i " " |
| Kristofor Peçi | Anëtar i " " |
| Kujtim Puto | Anëtar i " " |
| Petrit Plloçi | Anëtar i " " |
| Sokol Sadushi | Anëtar i " " |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i " " |
| Gjergj Sauli | Anëtar i " " |

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 30.6.2003 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 Akti që i përket:

KËRKUES: SERVET LIBOHOVA, përfaqësuar nga avokati Abaz Brati, me prokurë.
SUBJEKTE TE INTERESUARA:
1. ILIR THANA, në mungesë.
2. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, në mungesë.
3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË QARKUT TIRANË, në mungesë.
4. DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1399, datë 20.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, sepse vendimin e ka marrë jashtë rregullave të përcaktuara në nenet 472 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile.
- Shkeljet e lejuara kanë mohuar të drejtën e pronës së kërkuesit që është një e drejtë themelore kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesit Servet Libohova dhe trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarit Ihsan Libohova, me vendimin nr.135, datë 12.6.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë

Bashkisë Tiranë, u është kthyer një vilë me anekset përkatëse, ku përfshihet edhe objekti i quajtur magazina nr.2. Kthimi i kësaj magazine është bërë nga komisioni në kohën kur ajo ishte shitur nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me kontratën e datës 23.4.1992 në favor të subjektit të interesuar, Ilir Thana.

Kërkuesi së bashku me trashëgimtarët e tjerë, bazuar në vendimin e mësipërm të komisionit, kanë kërkuar me padi kundër subjektit të interesuar dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së magazinës, njohjen e pronësisë së tyre mbi këtë objekt dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Subjekti i interesuar, duke pretenduar se është pronar i ligjshëm i magazinës, ka kërkuar me kundërpadi në gjykatë, anulimin e vendimit të mësipërm të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Fillimisht, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, vendim të cilin e ka lënë në fuqi gjykata e apelit, por të dy këto vendime i ka prishur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.16, datë 14.7.2000 ka pranuar padinë dhe ka rrëzuar kundërpadinë.

Në bazë të rekursit të subjektit të interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1399, datë 20.12.2001, e ka gjykuar çështjen në fakt dhe ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e drejtë dhe duhet pranuar, sepse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor. Kolegji Civil i kësaj Gjykate ka pranuar shkaqet e rekursit dhe ka bërë vlerësimin e provave, duke u shprehur se: "... nga aktet shkresore që gjykata e apelit ka administruar ... prona objekt konflikti nuk është vërtetuar të ketë qenë në pronësi të trashëgimlënësit të paditësve ..." ose se: "... me këto akte nuk provohet që Ihsan Libohova krahas truallit dhe shtëpisë prej 20 dhomash të ketë pasur në pronësi edhe objektin e konfliktit ...", që është magazina nr.2.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vënë në diskutim problemet e ngritura në rekurs, ka pranuar një pjesë të provave e fakteve, kurse pjesën tjetër të tyre nuk e ka pranuar ose nuk e ka përmendur fare. Si rezultat i një rivlerësimi të tillë të provave, Kolegji ka marrë një vendim të kundërt me atë të gjykatës së apelit, duke vepruar në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore të reflektuar në vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës, në zbatim të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, rekurset e bëra për prishjen e vendimeve për vlerësimin e gabuar të provave i ka lënë jashtë kufijve të shqyrtimit të kësaj Gjykate.

Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim edhe me kërkesat e nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile, sepse me prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe gjykimin e çështjes në fakt, Kolegji ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë, në kushtet kur kjo dispozitë nuk parashikon të drejtën e kolegjit që, mbi bazën e vlerësimit të provave, të prishë vendimet e gjykatës së faktit e të apelit dhe të zgjidhë vetë çështjen.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar provat e administruara në të kundërtën e vlerësimit që u ka bërë atyre gjykata e apelit dhe duke e zgjidhur vetë çështjen, krejt ndryshe ka lejuar shkeljen e të drejtës së pronës së kërkuesit, e cila është një e drejtë themelore, nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1399, datë 20.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**
**Nr.30, datë 23.10.2003**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fehmi Abdiu | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci | Anëtar i " " |
| Gjergj Sauli | Anëtar i " " |
| Alfred Karamuço | Anëtar i " " |
| Kristofor Peçi | Anëtar i " " |
| Petrit Plloçi | Anëtar i " " |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i " " |
| Sokol Sadushi | Anëtar i " " |
| Kujtim Puto | Anëtar i " " |

me sekretare Drita Panda, në datë 15.9.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29 Akti që i përket:

KËRKUES: VIOLETA HANO, përfaqësuar nga avokat Fatmir Tartale, me prokurë.
SUBJEKTI I INTERESUAR:PASHK RAPI, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.348, datë 18.2.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës EUropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesja ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit:
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë lejoi zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor dhe nuk respektoi të drejtën time për t'u mbrojtur me avokat, megjithëse unë paraqita kërkesë për shtyrjen e këtij gjykimi.
- Kolegji Civil më vendosi në kushte të pabarabarta gjykimi, megjithëse e njoftova se avokati ishte i sëmurë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkueses dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesja Violeta Hano ka qenë palë paditëse në çështjen civile me të paditur subjektin e interesuar Pashk Rapi dhe me objekt të padisë pushim cenimi në posedim dhe rivendosje në posedim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1346, datë 17.4.2001, ka vendosur pranimin e padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.247, datë 4.3.2002, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe i ka rrëzuar padinë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Kërkuesja i ka kërkuar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë shtyrjen e gjykimit të çështjes me arsyetimin se avokati i caktuar prej saj ishte i sëmurë. Kjo kërkesë nuk u pranua nga ai Kolegj me arsyetimin se vetë kërkuesja duhet të merrte më parë masat për të pajisur avokatin me prokurë, dhe se duhet ta njoftonte gjykatën përpara gjykimit.

E drejta për t'u mbrojtur nëpërmjet avokatit është një element i rëndësishëm i procesit të

rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, por në çështjen në shqyrtim Gjykata e Lartë nuk i ka cenuar kërkueses ndonjë të drejtë të tillë.

Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet e veta duke shpallur në listat e gjyqeve datën e gjykimit të çështjes dhe duke i dhënë kohë palëve për t'u përgatitur. Pas kësaj, ishte detyrë e vetë kërkueses të merrte masat për të caktuar avokat që të përgatitej për një mbrojtje efektive.

Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë mban datën 2.4.2002 dhe është nënshkruar nga vetë kërkuesja Violeta Hano, ndërsa shqyrtimi i çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë është bërë në 18.2.2003. Nga verifikimi i bërë prej Kolegjit Civil, sikurse del nga materialet e dosjes, kërkuesja nuk kishte caktuar avokat me prokurë për t'u përfaqësuar në gjykim. Kjo rezulton jo vetëm nga mosparaqitja e prokurës, por edhe nga përgjigjja e dhënë para Kolegjit nga kërkuesja Violeta Hano. Në këto rrethana, gjykata me të drejtë e gjeti të pajustifikuar kërkesën e saj për shtyrjen e gjykimit për mosparaqitje të avokatit.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka vënë kërkuesen në kushte të pabarabarta me palën tjetër. Gjykata e Lartë ka zbatuar rregullat procedurale për zhvillimin e veprimtarisë së saj dhe kjo veprimtari nuk mund të pengohet në rastet kur palët nuk përmbushin detyrimet e tyre. Nocioni i të drejtave dhe i kushteve të barabarta në gjykim nuk mund të interpretohet i ndarë nga detyrimi i palëve për respektimin e rregullave, brenda të cilave gjykatat kanë detyrë t'i respektojnë të drejtat e tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICES

Nuk jemi dakort me konkluzionet e shumicës. Mendojmë se vendimi nr.348, datë 18.02.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe si i tillë duhej të shfuqizohej nga Gjykata Kushtetuese.

Pretendimi kryesor pranë Gjykatës Kushtetuese i kërkueses ka qenë mosrespektimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i të drejtës së saj për t'u mbrojtur me avokat, duke u vendosur kështu në kushte të pabarabarta gjykimi. Ne mendojmë se nga materialet e dosjes ky pretendim provohet plotësisht.

Përmes jurisprudencës së pasur të saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve në kuptimin kushtetues janë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Mbi këtë bazë është theksuar se gjykatave të të gjitha niveleve u dalin një sërë detyrash, në mënyrë që brenda kuadrit ligjor ekzistues dhe mundësive të garantojnë sa më mirë parimin e barazisë së armëve dhe të mbrojtjes efektive të palëve në gjykim. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka evidentuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e veçantë të mbrojtjes me avokat në gjykimet që zhvillohen në Gjykatën e Lartë. Çështjet që trajtohen aty kanë natyrë të mirëfilltë ligjore prandaj, të drejtat dhe liritë e shtetasve pranë kësaj gjykate mund të mbrohen me efektivitet dhe profesionalizëm vetëm përmes avokatit që përfaqëson palët.

Rezulton e provuar se ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kërkuesja është paraqitur vetë dhe i ka kërkuar që në fillim të seancës, kolegjit civil të kësaj gjykate, shtyrjen e gjykimit të çështjes me arsyetimin se avokati i caktuar prej saj ishte i sëmurë, gjë që vërtetohet edhe nga raporti mjeksor që përmban dosja. Pra, përderisa nuk mund të provohet e kundërta, duhet pranuar se ajo i kishte marrë masat për t'u përfaqësuar me avokat ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, por sigurisht, nuk mund të parashikonte që pikërisht këtë ditë, avokati i saj do të ishte i sëmurë.

Në vendim nuk përmenden një sërë faktesh të tjera që ka dosja dhe që u parashtruan në seancën gjyqësore që u zhvillua në Gjykatën Kushtetuese, të cilat, pavarësisht nga besueshmëria që paraqesin, përderisa nuk mund të rrëzohen, duhej të llogariteshin në favor të kërkesës. Kështu, u paraqit një prokurë përmes së cilës vërtetohet se rreth një javë para gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka caktuar si përfaqësues të saj ligjor pikërisht avokatin e deklaruar si mbrojtës të saj në seancën e zhvilluar pranë kësaj gjykate. Mosparaqitja e kësaj prokure së bashku me rekursin, u justifikua me praktikën që zbatojnë normalisht gjykatat e të gjitha niveleve, që do të thotë se ajo paraqitet dhe verifikohet ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Për më tepër, avokati i kërkueses theksoi në seancën e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë ishte hartuar nga vetë ai, pavarësisht se përmbante vetëm nënshkrimin e klientes së tij.

Duke qenë kështu, mendojmë se konkluzioni i shumicës se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet e veta me shpalljen e listës dhe të dates së gjykimit të çështjes, dhe kërkuesja duhej të merrte vetë masat në kohën e duhur për të caktuar avokatin që të përgatiste një mbrojtje efektive, nuk është i bazuar.

Për sa më sipër, mendojmë se në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkueses i është mohuar dukshëm e drejta e mbrojtjes. Në këtë gjykim ajo është vënë në pozitë krejt të pabarabartë me palën tjetër.

Tiranë, më 23.10.2003

A N E T A R A N E T A R K R Y E T A R
/ K. Peçi / dv/ A. Karamuço / dv/ F. Abdiu / dv
A N E T A R
/ Xh. Zaganjori / dv

**Fletorja Zyrtare** gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kodi Penal**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Mars, 2002 | **Kodi i Procedurës Penale**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Shtator, 2002 | **Kodi i Procedurës Civile**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Korrik, 2002 | **Kodi Civil**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Shtator, 2003 | **Kodi Rrugor**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Qershor,2002 |
| **Kodi Penal Ushtarak**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Tetor, 2002 | **Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Tetor, 2002 | **Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Shtator, 2003 | **Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Shtator, 2003 | **Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë**<br>*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*<br>Shtator, 2003 |

Doli nga shtypi më 27.10.2003

| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë